



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Administratës Zgjedhore**

**RELACION**  
**PËR PROJEKTVENDIMIN**

Data		
Nr.		
Prot		

**PËR**

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË DHE TË KATËRT**  
**TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË**  
**BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njih shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para ditës së votimit, caktohen Grupe Numërimi të Votave. Neni 95 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton rregullat për përbërjen e Grupeve të Numërimin të Votave.

Grupet e Numërimin të Votave përbëhen nga katër anëtarë, ku në çdo rast një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari, ndërsa anëtar i tretë propozohet nga partitë e shumicës qeverisëse dhe anëtar i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të Kodit Zgjedhor.

Neni 96, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive të opozitës parlamentare të regjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimin të Votave e ka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare.

## II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Për efekt referimi, KQZ do t'i referohet rezultatit të zgjedhjeve dhe numrit të mandateve të partive politike për legjislaturën e vitit 2021-2025.

Me vendimin nr. 21, datë 13 Korrik 2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Numri i mandateve të fituara nga partitë politike është si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë	74 mandate
2. Partia Demokratike “Aleanca për Ndryshim”	59 mandate
3. Lëvizja Socialiste për Integrim	4 mandate
4. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	3 mandate

Me shkresën nr. 259/1 prot. datë 24.01.2022, Kuvendi i Shqipërisë ka përcaktuar se partitë politike dhe numri i deputetëve për çdo parti politike janë konfiguruar si vijon:

1. Shumica parlamentare:
  - Partia Socialiste e Shqipërisë, 74 mandate
2. Pakica parlamentare:
  - Partia Demokratike “Aleanca për Ndryshim”, 59 mandate
  - Lëvizja Socialiste për Integrim, 4 mandate
  - Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, 3 mandate

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 722, datë 19.08.2023 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11 për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”, ka caktuar partitë politike që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ. Konkretisht Partia Socialiste ka propozuar kryetarin e KZAZ-së dhe Partia e Lirisë ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së. Këto subjekte kanë të drejtën të propozojnë anëtarin e parë dhe të dytë (numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-së) të KZAZ-së nr.11.

Referuar shkresës nr. 259/1 prot. datë 24.01.202 të Kuvendit rezulton se, përveç “Partisë Socialiste të Shqipërisë” nuk ka parti politike të shumicës parlamentare që ka fituar në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 të paktën dy mandate. Referuar nenit 96, pika 1/1, “Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë

*politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik”. Në këtë rast, e drejta për propozimin e anëtarit të tretë i takon “Partisë Socialiste të Shqipërisë”.*

Parti politikë të opozitës parlamentare që ka fituar të paktën 2 mandate në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 dhe që është regjistruar në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023 është “Partia Demokratike” (PDSH).

Në këto kushte, kur lista e partive të shumicës dhe pakicës parlamentare përmban vetëm një subjekt për secilin grupim politik (shumicë – opozitë), shorti për anëtarin e tretë dhe të katërt nuk mund të zhvillohet.

Sa më sipër referuar, e drejta për të propozuar anëtarin e tretë të GNV-së i kalon në këtë rast partisë së vetme të shumicës parlamentare “Partisë Socialiste të Shqipërisë”. E drejta për të propozuar anëtarin e katërt të GNV-ve i kalon partisë së vetme të shumicës parlamentare “Partisë Demokratike” (PDSH).

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”.

**Erion Meta** Drejtoria e Administratës Zgjedhore

**Majlinda Çelmeta** Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .....09.2023

Nr: .....

Ora: .....

PROJEKTVENDIM

PËR

**CAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARIN E TRETË DHE TË KATËRT  
TË GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË  
BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenit 95, pika 2, dhe nenit 96, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Partia politike e shumicës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e tretë të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, është “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Partia politike e opozitës parlamentare, që ka të drejtë të propozojë anëtarin e katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, është “Partia Demokratike”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: ... 09 2023 Nr: .....  
Ora: ....



“Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”